

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO	QEVERIA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS	MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË	MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
Njësie Org.	01B	Mir. P.F. Nr.	318
Org. Jedinice		B.F. Nr.	
Org. Unit		B.F. Nr.	
Nr. i faqeve	1	B.F. Nr.	16 02 22
Br. Stranica		B.F. Nr.	
No. pages		B.F. Nr.	



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije - Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë/a:	16.02.2022
Referenc-ë:	01B/027
Për/ Za/ To:	Drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA)
CC:	Instituti ATOMI
Përmes/Preko/Through:	Zv. Sekretarit të përgjithshëm, Fadile Dyla
Nga/ Od/ From:	Arbërie Nagavci - Ministre e MASHTI-t
Tema/ Subjekat/Subject:	Rekomandim për bashkëpunim dhe përkrahje të Garës "Kangaroo"



Të nderuar drejtorë të DKA-ve,

Përmes kësaj shkrese, ju informojmë se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), e ka miratuar dhe e përkrahë organizimin e Garës "Kangaroo" në Kosovë, në mënyrë që përmes këtij aktiviteti të promovohet matematika dhe rëndësia e saj në shkollat e Kosovës. Gara "Kangaroo" parasheh organizimin e testit të matematikës për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar (sipas moshave). Kjo garë do të shfrytëzohet për të identifikuar talentët e rinj në fushën e matematikës në Kosovë, në mënyrë që të ofrojë aktivitete dhe shërbime të ndryshme përkrahëse për këto talente në funksion të zhvillimit dhe avancimit maksimal të talentit, njohurisë dhe kompetencës së tyre në fushën e matematikës.

Ky aktivitet është në përputhje me objektivat e politikave të MASHTI-t, andaj i inkurajojmë të gjitha DKA-të që t'i ofrojnë Institutit ATOMI bashkëpunim të plotë gjatë zbatimit të këtij aktiviteti dhe brenda mundësive të tyre ta përkrahin këtë aktivitet.

Gjithashtu, i lusim Drejtorët e DKA-ve që t'i inkurajojnë drejtorët dhe mësimdhënësit që të bashkëpunojnë me personelin e Institutit ATOMI, në funksion të identifikimit dhe përkrahjes së nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës. Shpresojmë në mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe përkrahjen tuaj.

Me respekt,

Arbërie Nagavci  
 Ministre/MASHTI